



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

---

Nr. 1183/1 Prot.

Tiranë, më 29 / 07 / 2019

**V E N D I M**

**Nr. 98, Datë 29 / 07 / 2019**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>”, mori në shqyrtim ankesën me nr.45 Regj., datë 15.05.2019, të shtetasit L. M, kundër Institutit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Peqin, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “*gjendjes ekonomike*” dhe “*gjendjes shëndetësore*”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**KONSTATOI:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, shtetasi L. M në ankesën e sjellë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) pretendon se është diskriminuar nga punonjës të IEVP Peqin, duke cituar dy raste:

---

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

- Rasti i parë lidhet me mos lejimin e tij për të marrë pjesë në aktivitetet fetare dhe aktivitetet e tjera që zhvillon IEVP Peqin. Subjekti ankues pretendon se Specialistja e Edukimit pranë këtij Instituti e ka penguar për shkak se ai është i sëmure dhe ndodhet në Sektorin e Kujdesit të Veçantë. Ai citon se specialistja e ka quajtur atë të papërgjegjshëm, duke marrë kështu edhe kompetencën e mjekut specialist. Subjekti ankues pretendon se është diskriminuar nga ana e specialistes përmes moslejimit të tij për pjesëmarrje në aktivitetet e IEVP-së, në shkelje të parashikimeve ligjore duke e paragjykuar dhe diskriminuar atë.
- Rasti i dytë lidhet me mos plotësimin e kërkesës së tij drejtuar IEVP-së, për t'u pajisur me materiale hotelerie dhe higjienike, në kushtet e pamundësisë ekonomike dhe familjare të ankuesit. Ai është shprehur se sjellja e Institucionit ndaj tij është diskriminuese, fyese dhe ka krijuar një mjedis frikësues, armiqtësor, poshtërues dhe ofendues për personin e tij.
- Ankuesi ka pretenduar se është ankuar tek titullari i Institucionit për diskriminimin që po i bëhet atij, por nuk ka marrë asnjë përgjigje nga ana e IEVP Peqin.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e IEVP Peqin, për shkaqet sipërcituar dhe marrjen e masave për rregullimin e situatës.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Neni 1 i Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcakton se “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e

*Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.719/2 prot., datë 20.05.2019 iu kërkua informacion dhe dokumentacion provues I EVP Peqin dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB), lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

➤ Me shkresën me nr.4550/1 prot., datë 24.06.2019 DPB, ka informuar Komisionerin se:

*“Situata e këtij shtetasi të akomoduar në ambjentet e I EVP Peqin është sensitive për shkak të gjendejs të vështirë ekonomike të familjes së tij dhe në këto kushte atij i është ofruar nga Institucioni mbështetje e vazhdueshme materiale. Mbështetur në shkresën me nr.1212/1 prot., datë 11.03.2019 ky shtetas është akomoduar në Sektorin e Kujdesit të Veçantë (SKV) të kësaj I EVP-je, pasi vuan nga probleme të shëndetit mendor, diagnostikuar nga mjeku psikiatër me “çrregullime ankthi”. Pikërisht për shkak të këtyre specifikave shëndetësore, vendosja e tij në këtë sektor është bërë me qëllim stabilizimin dhe ruajtjen e një gjendjeje të qëndrueshme emocionale, pasi ky shtetas në mënyrë të vazhdueshme ka shfaqur probleme të përshtatjes, duke krijuar raporte konfliktuale me bashkëvuajësit, duke u kthyer në burim të vazhdueshëm konfliktesh në Institucion. Trajtimi i tij pranë këtij sektori bëhet nga një ekip multidisiplinar”.*

Në vijim citohet se në asnjë moment ky shtetas nuk është diskriminuar në asnjë nga situatat e pretenduara prej tij, duke argumentuar se:

*“Pretendimi se nuk është përfshirë në aktivitete, ka indicie nga një aktivitet i organizuar me datë 24.04.2019 në I EVP Peqin me rastin e festës së Pashkëve, si një bashkëpunim midis Institucionit dhe Kishës Ungjillore, e cila organizon rregullisht shërbesat fetare për të burgosurit që praktikojnë besimin katolik në I EVP. Në këtë aktivitet, duke qenë se kishte një*

*numër të kufizuar pjesëmarrësish (rreth 100) janë përfshirë të burgosurit që ushtrojnë rregullisht shërbesat fetare të besimit katolik në I EVP dhe që kanë patur marrëdhënie korrekte me bashkëvuajtësit. Po ashtu theksojmë ai ka marrë dy masa disiplinore brenda vitit 2019”.*

Ndërsa sa i takon aktiviteteve sportive të organizuara nga I EVP-ja ky shtetas ka marrë pjesë rregullisht në aktivitetet sportive në ambjentin e kalçetos, sikurse provohet nga grafikët e dërguar, të cilët janë të depozituar në dosjen e ankuesit pranë KMD-së; në aktivitetet e lojrave të tavolinës, (shah, tavëll, ping-pong) si dhe duke qenë se është evidentuar se ankuesi ka prirje në letërsi, poezitë e tij janë afishuar në sektorët e I EVP-së.

Lidhur me pretendimin e ankuesit për mosplotësim të kërkesave të tij për materiale hotelerie dhe higjienike, I EVP Peqin sqaron se, lidhur me sa mësipër, nga verifikimi i dokumentacionit (kartelat personale të marrjes në dorëzim të materialeve) dokumentohet se ky shtetas është furnizuar respektivisht në datat: 20.03.2019 dhe 27.05.2019, duke cilësuar se për rastin konkret dhe raste të ngjashme me të janë përpjekur t’i trajtojnë me prioritet pikërisht për shkak të specifikave të tyre.

2. Në vijim të procedurës së ndjekur për shqyrtimin e ankesës, si dhe në zbatim të Urdhërit nr.125, datë 18.07.2019 të Komisionerit, me datë 24.07.2019, pranë ambjenteve të I EVP Peqin u realizua inspektimi i cili kishte si objekt të tij marrjen e informacionit drejtëpërdrejtë si dhe dokumentacionin shkresor përkatës nga ana e këij Insitucioni.

Gjatë inspektimit u mor në cilësi prove dokumentacioni i kërkuar<sup>3</sup> si dhe u realizua një takim me shtetasin L. M, i cili informoi inspektorët e KMD-së se parashtrimet e paraqitura në ankesën e tij për diskriminim i kishte bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor nëpërmjet një Kërkesë-Padie drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Mbështetur në kopjen e Kërkesë-Padisë<sup>4</sup> së depozituar pranë KMD-së, bashkëlidhur ankesës, rezulton se subjekti ankues, pretendimin e tij për diskriminim nga ana e I EVP Peqin e ka bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Ankuesi ka ngritur pretendimin se është shkelur ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, duke cituar konkretisht dispozitat konkrete të këtij Ligji, si dhe duke kërkuar që nga ana e I EVP Peqin të merren masa për ndalimin e diskriminimit ndaj tij.

---

<sup>3</sup> Referuar procesverbalit të mbajtur gjatë inspektimit, si dhe akteve shkresore të marra në cilësi prove.

<sup>4</sup> Kërkesë Padi e depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan me datë 09.05.2019.

Bazuar në sa më sipër, shtetasi L. M, në kërkesë padinë e paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ka pretenduar trajtimin e disfavorshëm dhe diskriminues nga ana e kësaj INEVP-je, për të njëtat shkaqe që ka ngritur dhe në ankesën e tij pranë KMD-së.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkakun ligjor të padisë, citohet: “...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadia në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadisë. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadisë. Ai mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërtimeve të padisë gjendet në pjesës përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë.”

Për sa më sipër, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, si dhe në mbështetje të paragrafit 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet: “...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata”, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën nr.45 Regj., datë 15.05.2019, të shtetasit L. M, kundër IEVP Peqin.**

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku parashikohet shprehimisht se: “Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

## **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 36 të Ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 21, pika 1, nenit 32, pika 1, germa a), nenit 33, pikat 1, 3, 5, 7 dhe 10, si dhe nenit 36, pika 3, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës me nr.45 Regj, datë 15.05.2019, të shtetasit L. M, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha: Të mira dhe shërbime  
Shkaku: Gjendja ekonomike, gjendja shëndetësore